



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
Avokati i Popullit



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[eëë.avokatipopullit.gov.al](http://eëë.avokatipopullit.gov.al)

Nr. 67 Prot

Tiranë, 17/03/2017

**Lënda:** *Për zbatimin e vendimit nr.18/2017, të Kuvendit të Shqipërisë*

**Drejtuar:** **Zj. Genoveva Ruiz-Calavera**  
Kryetare e Bordit Drejtues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

**Për dijëni:** **Z. Jon Smibert**  
**Ambasada Amerikane në Shqipëri**  
**OPDAT**

Tiranë

*E nderuara zj. Ruiz-Calavera,*

Sikurse ndoshta jeni në dijëni, Kuvendi i Shqipërisë miratoi dje vendimin nr.18/2017, ku parashikohet riplotësimi i dokumentacionit nga ana e kandidatëve aplikantë të listuar në listën e kandidatëve, të cilët nuk plotësojnë kriteret formale ligjore për secilin pozicion, si dhe vazhdimin e rolit monitorues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, gjatë gjithë këtij procesi në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Aneksi për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe ligjin nr.84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Në vazhdim të ushtrimit të monitorimit të realizuar nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, pas dërgimit të letrës së datës 7.02.2017, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave z. Agaçi, letër ku Avokati i Popullit ishte në kopje për dijëni dhe e cila është protokolluar nga ana e tij, me nr.34 datë 17.02.2017, jemi të gatshëm të vazhdojmë bashkëpunimin për ecurinë e zbatimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe ligjit nr.84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Ndërkohë, duam t'ju falenderojmë për bashkëpunimin tonë të mëparshëm për zbatimin e procedurave ligjore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për ngritjen e institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Në kushtet kur Kuvendi i Shqipërisë ka nxjerrë vendimin nr.18/2017, për zbatimin e të cilit nevojitet riplotësimi i dokumentacionit nga ana e kandidatëve aplikantë, të cilët pas zhvillimit të procedurave përkatëse nga ana e Avokatit të Popullit, si dhe vlerësimit dhe rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), janë listuar në listën e kandidatëve të cilët nuk plotësojnë kriteret formale ligjore për secilin pozicion, lind nevoja e bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet nesh për mbarëvajtjen e këtij procesi.

Sa më sipër, për kryerjen një procesi në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Aneksi për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe ligjin nr.84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe për të siguruar monitorimin e pandërprerë të tij nga ana e ekspertëve monitorues të ONM-së, del e nevojshme marja e masave të dyanshme për koordinimin e punës për zhvillimin e mëtejshëm të procesit sipas parashikimeve të vendimit nr.18/2017, të Kuvendit të Shqipërisë.

*Me respekt dhe konsideratë të lartë ndaj Jush,*

**AVOKATI I POPULLIT**

